



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 818/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Nenad Lazić kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Armend Shkoza, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur për shkak të parregullsive dhe të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Armend Shkoza, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11.11.2013, nga Armend Shkoza, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se me datën 11 nëntor 2013 në ora 11:00 nga anëtari i saj në KQZ Adnan Rustemi kanë pranuar raportin zyrtar të QNR-së të datës 11 nëntor në të cilin është përshkruar ecuria e procedimit të materialit zgjedhor të pranuar nga KKZ-ja. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë raport është përshkruar gjendja aktuale në QNR-së e që sipas këtij raporti në faqen 2 është theksuar se në karantin kanë qenë 534 të cilat sipas procedurave të QNR-së nuk mund të procedohen si të rregullta, andaj raporti i QNR-së i ka grupuar në katër grupe mangësitë që janë shkaktuar për karantinimin e këtyre kutive. Me këtë rast parashtruesi i ankesës përmend rastin e Vitisë ku rezultati preliminar tregon se dallimi në mes të kandidatit të LVV-së Salih Salihu dhe kandidatit të PDK-së Nexhmedin Arifi është i ngushtë ku ky dallim është afër 200 vota. Sipas parashtruesit të ankesës parregullsitë e evidentuara në QNR cenojnë objektivitetin e rezultatit zgjedhor dhe se në bazë të raportit të QNR-së janë 10 kuti të votimit për kryetar të komunës që gjenden në karantinë përshkak të parregullsive që janë të cekur në këtë raport. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të urdhëroj rivotim për zgjedhje për kryetar të komunës për vendvotimet 2601X/03R, 2605D/04R, 2606D/01R, 2609D/01R, 2609D/02R, 2610D/02D, 2611D/01R, 2617D/03D, 2628D/01D dhe 2630D/02D

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar sepse me nenin 105.1 të LZP-së parashihet se: *“Ankesa lidhur me administrimin në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dorëzohet me shkrim pranë PZAP-it brenda 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*. Sipas kësaj dispozite del se ankesa në PZAP nga palët e interesuar mund të parashtrohet për administrimin në QNR gjatë numërimit. Parashtruesi i ankesës më këtë rast nuk ka parashtruar ankesë për administrimin në QNR, por ankesa është e parashtruar për raportin e QNR-së dhe ndaj vendimit të QNR-së për shkak se disa kuti të votimit QNR-ja ka vendosur ti dërgoj në karantinë. Më këtë rast PZAP-i vlerësoi se ankesa është e palejuar ngase me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së nuk parashihet që të parashtrohet ankesë në PZAP ndaj raportit apo vendimeve të QNR-së për më tepër me nenin 122.1 të LZP-së përcaktohet se për çfarë vendime të KQZ-së ka të drejt PZAP-i, të merr vendime.

Andaj, bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parashihet se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet”* dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatsllhme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”*, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 818/2013 më datën 12.11.2013



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.